

Njoftim i përqendrimit me të cilin LEO II-VV11 GmbH Munich, Gjermani, do të fitoj kontroll mbi Vitesko Tehnologhis Emitek GmbH. Lohmar, Gjermani

(lënda nr. 08-142/2022)

Në përputhje me nenin 15 të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 145/10, 136/11, 41/14, 53/16 dhe 83/18), më 25.10.2022, në Komisionin për mbrojtjen e konkurrencës është dorëzuar njoftim i përqendrimit me të cilin shoqëria **LEO II-VV11 GmbH**, me seli në Ottosstrase 1, 80333 Munich, Gjermani, synon të fitoj në mënyrë indirekte kontrollin mbi **Vitesko Tehnologhis Emitek GmbH (Vitesco Technologies Emitek GmbH)**, me seli në Hauptshtrase 128, 53797 Lohmar, Gjermani, (**VT Emitek**), shoqëri të varura të sapokrijuara (**NewCos**) të VT Emitek në Japoni, SHBA, Kore, Indi dhe Kinë, duke përfshirë bizneset e ndara në vend të Vitesko Tehnologhis GmbH, me seli në Simensstrase 12, 93055 Regensburg, Gjermani, patundshmëritë në Lohmar dhe Ajzenah, Gjermani, dhe disa punonjës dhe të drejta të pronësisë intelektuale në lidhje me atë që u tha më sipër (**Emitek Biznis ose Grupi i synuar**).

Pjesëmarrësit në përqendrim dhe aktivitetet e tyre të biznesit:

LEO II-VV11 GmbH është një shoqëri për qëllime të veçanta që operon si një shoqëri holding. LEO II-VV11 është një shoqëri e varur indirekte që është 70% në pronësi të Lenbah Ekviti Opportunities II. GmbH & Co. KG (Lenbach Equity Opportunities II. GmbH & Co. KG), një fond kapitali privat i këshilluar nga DUBAG. Grupi DUBAG është një ekip i specializuar këshillues për investime me qendër në Munich, i cili menaxhon fondet e kapitalit privat, qëllimi i të cilit është blerja dhe zhvillimi aktiv i shoqërive në situata të veçanta.

Emitek Biznisot me seli në Gjermani, siguron baza katalizatorësh të cilat përdoren në zgjidhjet e pajisjeve për reduktimin e emetimeve në industrinë e automobilave, duke përfshirë makinat e pasagjerëve, automjetet e lehta dhe të rënda tregtare, pajisjet industriale dhe makinat me dy rrota. Është aktive në zhvillimin, prodhimin dhe shpërndarjen e produkteve për të reduktuar emetimet e ndotësve, siç janë bartësit të katalizatorëve metalikë, katalizatorët me ngrohje elektrike dhe filtrat për motorët me djegie të brendshme

Parashtruesi konsideron se tregjet relevante të produkteve mund të përkufizohen si treg për shitjen dhe prodhimin e pajisjeve për trajtimin e njëpasnjëshëm të gazrave të shkarkimit duke aplikuar në lloje të ndryshme automjetesh.

Në bazë të shqyrtimit paraprak, Komisioni konstatoi se përqendrimi në fjalë mund të bie nën dispozitat të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës. Megjithatë, vendimi përfundimtar për këtë çështje është i rezervuar.

Komisioni fton palët e treta të interesuara të paraqesin vërejtjet dhe mendimet në lidhje me këtë përqendrim te Komisioni. Vërejtjet dhe mendimet e palëve të treta të interesuar mund të dërgohen edhe me faks: 02 3296 466, në adresën: rr. Shën Kirili dhe Metodi nr. 54, Shkup ose me email: kzk@kzk.gov.mk dhe të njëjtat duhet të arrijnë te Komisioni në afat prej 10 ditëve nga dita e publikimit të këtij njoftimi.

02.11. 2022

Shkup

